

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË LUSHNJË
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 8677 Prot

Lushnjë, më 13.11.2024

SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE SPECIALIST I TEKNOLOGJISE DHE INFORMACIONIT

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56/7, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit nr.622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Vendimit nr. 13, datë 12.03.2024 të Këshillit të Gjykatës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

1 (një) pozicion - Specialist IT dhe Statistike, kategoria e pagës IV-2

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës në pranimin në shërbimin civil për kategorinë drejtuese.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE: 02 Dhjetor 2024.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR: 09 Dhjetor 2024.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin Specialist IT dhe Statistikë është:

Nëpunësi civil gjyqësor, specialist i teknologjisë së informacionit ushtron në veçanti këto kompetenca:

- a) zbaton aktet normative nënligjore në fuqi lidhur me teknologjinë e informacionit;
- b) mirëmban sistemin ekzistues të kompjuterave në drejtim hardçare dhe softçare kryen kontroll periodik mujor të gjendjes së pajisjeve elektronike të gjykatës si dhe backup periodik, zakonisht ditor, të të dhënave sensitive, databazës së sistemit të të dhënave ARK.IT, së sistemit audio RDA, si dhe arkivit qendror të transfertës së gjyqtarëve;
- c) bashkëpunon dhe mban lidhje me sektorët dhe eprorët përkatës për problemet e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë por pa u kufizuar në konfigurimin e email, serverit të brendshëm si dhe domanit të gjykatës, krijimin e përdoruesit e gjykatës (kryetar, kancelar, gjyqtar, sekretarë, etj.), korigjimin e gabimeve të bëra nga përdoruesit me lejen e eprorit të gjykatës, pajisjen e çdo nëpunës civil gjyqësor të gjykatës me akseset e nevojshme në sistemet elektronike, në përputhje me detyrat e punonjësit; kopjimin e CD-ve audio të dosjeve të dorëzuara nga sekretarët; ndërhyrjen në sistem për ndryshimin e seksionet e gjyqtarëve në bazë të urdhrat të nxjerrë nga Këshilli i Gjykatës;
- ç) monitoron, administron dhe mirëmban infrastrukturën kompjuterike dhe informatike në gjykatë me anë të operacioneve periodike për të garantuar funksionimin e tyre normal, përfshirë këtu (por duke mos u kufizuar me to) testimin e pajisjeve, monitorimin, përditësimin, dhe kryerjen e kopjeve rezervë dhe raporteve, etj.,-gjurmimin e çdo veprimi të kryer nga përdoruesit e sistemit si dhe të ngarkesës së gjyqtarëve që marrin pjesë në short;
- d) ofron mbështetje për gjyqtarët si dhe nëpunësit civil gjyqësor pa vonesë në raste kërkesash për problemet kompjuterike për gjykatën;
- dh) mirëmban dhe mbështet infrastrukturën informative të gjykatës: rrjetin e brendshëm kompjuterik (LAN/WAN) dhe siguron komunikimin e të dhënave;
- e) përditëson faqen zyrtare të gjykatës me informacionet më të fundit në bashkëpunim me sektorët e tjerë, duke përfshirë por pa u kufizuar në: afshimin e listave të gjykimeve në faqen e gjykatës, ndalimin e publikimit të dosjeve me të dhëna tepër sensitive, siç është birësimi, etj, në faqen e gjykatës;
- ë) harton dhe zbaton politikën e sigurisë informative të gjykatës duke instaluar, konfiguruar, dhe mirëmbajtur sisteme kundër programeve dashakeqëse, ndërhyrëse (mure mbrojtës, antiviruse, etj.) të tilla si instalimin, konfigurimin dhe troubleshooting e kompjuterëve dhe netvorkut të gjykatës; mbrojtjen e të dhënave të brendshme nga infiltrimi i jashtëm përmes enkriptimit, ruajtjes së sigurtë të të dhënave, instalimit të antiviruseve dhe softveve anti spam, dhe mjeteve të tjera të nevojshme;
- f) ofron udhëzime dhe trajnime për stafin e gjykatës, sipas nevojës, për përdorimin e programeve që përdoren;
- g) harton dhe monitoron respektimin e standardeve të teknologjisë së informacionit që janë tepër të rëndësishme për integritetin, sigurinë dhe performancën e infrastrukturës teknike të gjykatës;
- gj) mbikëqyr zbatimin dhe performancën e të gjitha nismave që gjykata ndërmerë në lidhje me teknologjinë; zhvillon, për aq sa është e mundur, procedura të reja të IT-së për të rritur efikasitetin dhe për të lehtësuar punën e punonjësve të gjykatës;
- h) bashkëpunon me sektorët e tjerë të gjykatës statistika për raportimet për qëllime të ndryshme sipas parashikimeve ligjore në fuqi;
- i) ndërton dhe mirëmban një sistemi elektronik të brendshëm të statistikave të kategorive të ndryshme të të dhënave në bashkëpunim me nëpunësit civil gjyqësor përkatës: të dhënat volumetrike, të inventarit dhe të përpunimit për efekt të matjes së performancës së gjykatës dhe nëpunësve civil të saj;
- j) mban kontakte me kompanitë kontraktore që ofrojnë shërbime të ndryshme suporti si, shërbimi i printimit, shërbimi i audios, si dhe shërbimi i internetit;

- k) harton, sipas rastit edhe në bashkëpunim me nëpunësin civil gjyqësor të prokurimeve publike, specifikimet teknike të pajisjeve elektronike të gjykatës;
- l) kryen çdo detyrë tjetër që lidhet me teknologjinë e informacionit apo statistikat që I caktohet nga kancelari dhe/ose Këshilli i Gjykatës.

LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

12.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b. të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. të jetë diplomuar në Inxhinieri Informatike , Teknologji Informacioni, Informatike të paktën në nivelin “Bachelor” ose të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit arsimit të lartë.
- b. Te kete kryer te paktën nje vit praktike profesionale ose cdo lloj pervoje tjeter profesionale qe lidhet me gjykatën.
- c. Aftesi te tjera: Te kete certifikime profesionale ne fushen e IT;
- d. Te zoteroje mire gjuhe te huaj - preference per gjuhete e BE-se;
- e. Te kete aftesi shume te mira komunikimi dhe nderveprimi.

5.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, dokumentet si më poshtë:

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Formular të vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- f. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- g. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h. Aktin e deklarimit lidhur me statusin e nëpunës civil gjyqësor të konfirmuar në detyrë, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- i. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Rruga “Qemal Stafa” Lushnjë nëpërmjet shërbimit postar brenda dates **02.12.2024**.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

9.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **03.12.2024**, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

9.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTESITE DHE CILESITE MBI TE CILAT DO TE ZHVILLOHET INTERVISTA

a. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.

Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “Për mbledhjen e të dhënave personale”

Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “Për nënshkrimin elektronik “

Ligji nr. 10325 datë 23.09.2010 “Për bazën e të dhënave shtetërore”

Ligji nr 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”

9.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur prej tyre dhe intervistes, nga Këshilli i Gjykatës sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të vlerësohen:

a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;

b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,

c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

9.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të internetit të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës.

j. . PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës.

II. 1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil

gjyqësor janë:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
 - b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
 - d. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
 - e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
 - f. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. të jetë diplomuar në Inxhinieri Informatike , Teknologji Informacioni, Informatike të paktën në nivelin “Bachelor” ose të barasvlershme me të, sipas përcaktimeve të legj islacionit arsimit të lartë.
- b. Te kete kryer te pakten nje vit praktike profesionale ose cdo lloj pervoje tjeter profesionale qe lidhet me gjykaten.
- c. Afitesi te tjera: Te kete certifikime profesionale ne fushen e IT;
- d. Te zoteroje mire gjuhe te huaj - preference per gjuhet e BE-se;
- e. Te kete afitesi shume te mira komunikimi dhe nderveprimi.

5.2. . DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Jetëshkrim i plotësuar (CV të përshkrimit të karrierës) duke saktësuar ndër të tjera edhe kontaktet e sakta: email/adresë postare/numër telefoni.
- b. Fotokopje të diplomës së arsimit të lartë (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- c. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f. Formular i vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- h. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces penal;
- i. Vërtetim nga prokuroria qe nuk është në ndjekje penale.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë në adresën e vendndodhjes së gjykatës: Rruga “Qemal Stafa“ Lushnjë nëpërmjet shërbimit postar brenda datës

09.12.2024.

5.3. . REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **10.12.2024**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

5.4. . FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË

ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- f. Ligji nr.98/2016 “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”.
- Ligji nr. 9887 datë 10.03.2008 i ndryshuar me ligjin Nr 48/2012 “ Për mbledhjen e të dhënave personale”
- Ligji nr 9880 datë 25.02.2008 “ Për nënshkrimin elektronik “
- Ligji nr.10325 datë 23.09.2010 “ Për bazën e të dhënave shtetërore”
- Ligji nr9918 datë 19.05.2008 “ Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a. Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

11.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës.

Këshilli i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë

- V.O: Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij www.klgj.al

KËSHILLI GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË LUSHNJË